



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 271, Datë 19.09.2023

**MBI
RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “KORPORATA
ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE” (KESH) SH.A., NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 13 dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.09.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1796/6 prot., datë 14.09.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE” (KESH) sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE” (KESH) sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1796/1 prot., datë 18.08.2023, aplikoi për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe me vendimin nr. 262, datë 31.08.2023, bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për kërkesën e protokolluar në ERE.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 01.09.2023 dhe 02.09.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.09.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 1796/5 prot., datë 04.09.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar vendimin për fillimin e procedurës së licencimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Dokumentacioni i këtij aplikimi rezulton tërësisht i plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën Nr. 437, Seria F19, të shoqërisë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE” (KESH) sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar, duke filluar nga data 29.02.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI